


# Gratë në Politikë II:

## Politikëbërja e përgjegjshme gjinore në nivelin lokal dhe qendror





## GRATË NË POLITIKË II: POLITIKËBËRJA E PËRGJEGJSHME GJINORE NË NIVELIN LOKAL DHE QËNDROR

Ky publikim është financuar nga Fondi i Iniciativave Lokale të Kanadasë (CFLI) – një iniciativë e Qeverisë së Kanadasë. Përbajtja e këtij botimi është përgjegjësia e vetme e Grupit për Ballkan dhe nuk reflekton qëndrimet e donatorëve.

Activity supported by the  
Canada Fund for Local Initiatives  
Activité réalisée avec l'appui du  
Fonds canadien d'initiatives locales

The logo for Canada, featuring the word 'Canada' in a bold, black serif font with a small red maple leaf icon above the 'a'.

dhe Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë



Norwegian Embassy

**Autor:** Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan (BPRG)

# **PËRMBAJTJA**

---

<b>PËRMBLEDHJE</b>	<b>4</b>
<b>REKOMANDIME</b>	<b>6</b>
<b>HYRJE</b>	<b>8</b>
<b>ADRESIMI I MANGËSIVE MES GRAVE VENDIMMARRËSE TË NIVELEVE TË NDRYSHME TË LEGJISLATIVIT</b>	<b>10</b>
<b>SIGURIMI I PËRFAQËSIMIT EFIKAS</b>	<b>15</b>
<b>PJESËMARRJA E PUBLIKUT NË HARTIMIN E LIGJEVE DHE POLITIKAVE</b>	<b>18</b>
<b>MONITORIMI I LEGJISLATIVIT EKZISTUES</b>	<b>23</b>
<b>PËRFUNDIME</b>	<b>27</b>
<b>PËRFAQËSIMI I GRAVE: NDIKIMI NË POLITIKËBËRJE DHE NXITJA E SHTRIRJES</b>	<b>29</b>

## PËRMBLEDHJE

Sigurimi i barazisë së qëndrueshme gjinore brenda institucioneve publike në Kosovë vazhdon të mbetet çështje vështirë e arritshme. Gratë nuk përfaqësohen si duhet nëpër pozita vendimmarrëse (politike), në ndërkohë që as politikën nuk janë hartuar duke e përfshirë perspektivën gjinore. Rrjedhimisht, nevojitet një institucionalizim i ndryshimeve të konsiderueshme për t'u siguruar integrimi i duhur gjinor në kuadër të gjithë politikëbërjes. Kuota gjinore prej pesëdhjetë (50) përqind, e paraparë në Ligjin për Barazi Gjinore, duhet të harmonizohet me të gjitha ligjet e tjera ekzistuese, duke përfshirë edhe Ligjin për Zgjedhjet Përgjithshëm. Veç kësaj, Kuvendi i Kosovës duhet të themelojë ose mandatojë një Komision të përhershëm për Barazi Gjinore, i cili do t'i shqyrtonte të gjitha projektligjet që lidhen me kriteret e integritit të perspektivës gjinore. Mbledhja e saktë e të gjitha të dhënave të shpërndara nëpër institucione publike është vendimtare për një hartim më të mirë të politikave përfshirëse. Mbi të gjitha, bashkëpunimi ndërmjet grave përfaqësuese në politikë, në kuvendet komunale dhe ato në Kuvendin e Kosovës, është jetik për arritjen e pjesëmarrjes së grave në konsultime publike dhe në nismat legjislative për integrim gjinor.

Integrimi i perspektivës gjinore mund të institucionalizohet përmes instrumenteve të ndryshme në të cilat kanë qasje përfaqësuesit politikë. Përveç kuotës, Ligji për Barazi Gjinore përcakton edhe standardin për integrim gjinor në të gjitha nivelet e planifikimit politik. Kjo nënkupton që përfaqësuesit politikë dhe shërbyesit civilë duhet të përfshihen aktivisht në monitorimin e ligjeve dhe politikave që bazohen në të dhënat e zërthyerë mbi baza gjinore. Sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit dhe Ligjit për Barazi Gjinore, përfaqësueset politike (gratë) kanë mundësi të krijojnë politika lokale/qendrore, të sigurojnë pjesëmarrjen publike të qytetarëve në vendimmarrje dhe të monitorojnë implementimin e kriterëve ligjore që ndërlidhen me integrimin e politikave gjinore në nivel legjislativ.

Aktualisht ekziston një mungesë e theksuar e bashkëpunimit ndërmjet grave anëtare të kuvendeve komunale dhe deputeteve. Nevojat e identifikuar të qytetarëve në nivel lokal rrallëherë adresohen nga politikëbërësit lokalë, e aq më pak nga ata në nivel qendror. Përfaqësueset e grave dhe forumet përkatëse drejtuese nuk bashkëpunojnë në mënyrë efikase në adresimin e çështjeve relevante që lidhen me integrimin e perspektivës gjinore në nivelin lokal apo atë qendror. Përveç kësaj, ato dështuan edhe në zhvillimin dhe sigurimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në konsultimet publike lidhur me çështjet e ndryshme të politikave sektoriale. Edhe pse Ligji për Barazi Gjinore i definon standardet ligjore të integritit të perspektivës gjinore, përfaqësueset politike të grave në të dy nivelet nuk angazhohen sa duhet për monitorimin e asaj nëse implementimi i atyre standardeve është duke u realizuar.

Një përfaqësim efikas, i cili do të sigurojë pjesëmarrjen publike dhe monitorimin e plotë, në fakt varet nga ajo se si këta dy faktorë i adresojnë mangësitë e integritit të perspektivës gjinore në institucionet publike. Çfarëdo përpjekje që aspiron përmirësimin e bashkëpunimit legjislativ për integrimin e perspektivës gjinore nxitë një proces që këto tri aspekte i ndërthurë në mënyrë dinamike. Bashkëpunimi legjislativ në nivel lokal dhe qendror duhet të sigurojë se pjesëmarrja e grave në konsultime publike është e garantuar në të gjitha propozimet e politikave sektoriale. Vetëm nëpërmjet një të kuptuari gjithëpërfshirës të nevojave të qytetarëve, përfaqësueset politike të grave mund t'i ushtrojnë kompetencat e veta ligjore për mbrojtjen dhe shtyrjen përpara të propozimeve sa më gjithëpërfshirëse legjislative. Mirëpo, këto mekanizma nuk do të sjellin rezultate nëse mungon vullneti politik për arritjen e mbikëqyrjes dhe monitorimit të paanshëm të legjislationit. Sa i përket Ligjit për Barazi Gjinore, rëndësia dhe përfitimet shoqërore nga ai janë të mëdha për aq sa realizohet implementimi dhe monitorimi sistematik i tij.

## REKOMANDIME

Për avancimin e integritit të perspektivës gjinore brenda gjithë politikëbërjes nevojitet një grup i definuar qartë i veprimeve të matshme. Për ta realizuar këtë, kërkohet një përkrahje institucionale dhe politike. Institucionet publike dhe shërbimet e tyre respektive civile duhet të sigurohen se ato politika bazohen në integrimin e plotë gjinor, jo vetëm gjatë hartimit por edhe edhe implementimit të tyre. Për plotësimin e këtij kushti, përfaqësuesit politik të nivelit lokal dhe atij qendror duhet të mobilizohen dhe të sigurohen se i gjithë legjislati i miratuar garanton kushte të favorshme për barazi gjinore. Për t'u siguruar se integrimi i perspektivës gjinore është standardizuar në të gjitha institucionet publike, institucionet dhe akterët politikë duhet që:

1. Të rifillojnë procesin e reformës elektorale, dhe harmonizimi i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme me Ligjin për Barazi Gjinore.. Këtu përfshihet edhe zëvendësimi i kuotës gjinore prej tridhjetë (30) përqind me kuotën prej pesëdhjetë (50) përqind, siç përcaktohet me Ligjin për Barazi Gjinore;
2. Kuvendi i Kosovës të themelojë një Komision të përhershëm për Barazi Gjinore. Ai do të sigurojë se i gjithë legjislati (projektligjet) i plotëson kriteret e integritit të perspektivës gjinore, siç theksohet në Ligjin për Barazi Gjinore. Njëri prej komisioneve ekzistuese (si p.sh. Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione) do të mund ta marrë përsipër këtë rol.
3. Deputetet ta shfrytëzojnë pozitën e tyre si përfaqësuese politike në nivel qendror për një mbështetje më të vendosur për pjesëmarrjen e grave në konsultime publike. Kryesueset dhe anëtarët e komisioneve parlamentare duhet të sigurohen që projektligjet në Kuvendin e Kosovës i përmbushin kërkesat e domosdoshme publike, respektivisht nevojat konkrete të grave;

4. Anëtarët e kuvendeve komunale t'i amandamentojnë apo të propozojnë rregullore të reja komunale, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore. Amandamentet/propozimet duhet të sigurojnë që rregulloret e respektojnë kuotën prej pesëdhjetë (50) përqind, dhe se bazohen në të dhënat e zbërthyer mbi baza gjinore;
5. Kuvendet komunale t'i implementojnë në mënyrë strikte kërkesat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale për organizimin e (të paktën) dy takimeve publike me qytetarë brenda vitit. Nëpërmjet informimit dhe nxitjes së grave për të qenë pjesë e konsultimeve publike, anëtarët e kuvendeve komunale duhet të insistojnë në sigurimin e një pjesëmarrjeje të barabartë gjinore të qytetarëve në ato takime;
6. Të mobilizohen anëtarët e kuvendeve komunale dhe - në kuadër të kuvendeve komunale - të krijojnë komisione ndihmëse dhe këshillëdhënëse për barazi gjinore. Ato, bashkë me qytetarët pjesëmarrës në komisione, duhet t'i diskutojnë dhe filtrojnë (nga këndvështrimi gjinor) politikat lokale dhe të propozojnë veprime dhe iniciativa konkrete për amandamentimin e akteve ekzistuese, ose akte të reja komunale;
7. Përmes punës së tyre në komisionet komunale/parlamentare, përfaqësueset politike të nivelit lokal dhe atë qendror duhen të adresojnë mungesën e mbledhjes së të dhënave të zbërthyer mbi baza gjinore në departamentet/divizionet komunale dhe ministrore. Komisionet komunale dhe parlamentare duhet të përdoren si instrumente për ngritjen e ndërgjegjes mbi masat ndëshkuese nëse institucionet dështojnë të raportojnë për të dhënat e zbërthyer mbi baza gjinore;
8. Donatorët të japin mbështetjen e duhur për institucionet publike dhe për shërbimin civil, me qëllim të rritjes së kapaciteteve për mbledhjen e të dhënave të zbërthyer mbi baza gjinore, dhe të vlerësimit të ndërhyrjeve politike mbi baza gjinore.

## HYRJE

Përfaqësimi i barabartë gjinor gjatë hartimit të politikave mbetet një sfidë e madhe për institucionet e Kosovës. Përkundër faktit se i nënshtrohen ligjit tejet të avancuar për Barazi Gjinore (LBGj), institucionet e Kosovës po dështojnë vazhdimisht në përmbushjen e kërkesave ligjore të definuara në të.<sup>1</sup> LBGj-ja e vitit 2014 e rregullon një numër të veprimeve që për synim kanë arritjen e përfaqësimit të duhur gjinor në nivel politik dhe në atë të politikave. Në nivel politik, ligji e përcakton kuotën gjinore prej pesëdhjetë (50) përqind për të gjitha institucionet legjislative, ekzekutive dhe publike.<sup>2</sup> Në nivelin e politikave ndërkaq ligji e definon kornizën gjithëpërfshirëse të integritit gjinor për nivelet e ndryshme të politikëbërjes.<sup>3</sup>

Ligjvënësit në Kuvend të Kosovës kanë kompetenca për të përpiluar korniza ligjore që e rregullojnë përfaqësimin politik dhe, përgjithësisht, integrimin gjinor në politikë. Mirëpo, vullneti politik i deputetëve është elementi kyç që ndikon në ndryshime në të dy këto fusha. Në rastin e parë (atë të përfaqësimit politik), Kuvendi i Kosovës është nikoqir i debatit të politizuar dhe të polarizuar për eliminimin e dallimeve mes Ligjit për Barazi Gjinore dhe Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.<sup>4</sup> Së fundmi, Institucioni i Ombudspersonit (IO) ngriti një padi ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shkak të mospërkrahjes së përfaqësimit të barabartë gjinor në listat e partive politike, siç kërkohet me standardet e LBGj-së.<sup>5</sup>

<sup>1</sup> Grupi për Ballkan, “Gratë në politikë: (Pa)Barazia gjinore në politikë dhe vendimmarrje”, shkurt 2019. URL: <https://balkansgroup.org/grate-ne-politike-pabarazia-gjinore-ne-politike-dhe-vendimmarrje-3/>

<sup>2</sup> Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, Neni 6(8)

<sup>3</sup> Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, Neni 5

<sup>4</sup> Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore dhe Ligji Nr.003/L-073 për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

<sup>5</sup> Avokati i Popullit paditë KQZ-në, shtator 2019: [https://kallxo.com/lajm/avokati-i-popullit-padit-kqz-ne/Institucioni\\_i\\_Ombudspersonit,\\_Padi\\_civile\\_lidhur\\_me\\_çeshtjen\\_e\\_diskriminimit\\_te\\_grave\\_në\\_zgjedhje](https://kallxo.com/lajm/avokati-i-popullit-padit-kqz-ne/Institucioni_i_Ombudspersonit,_Padi_civile_lidhur_me_çeshtjen_e_diskriminimit_te_grave_në_zgjedhje) URL: [https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2019/10/ALB-Padia-civile-lidhur-me-ceshtje-te-diskriminimit-te-grave-n%C3%AB-zgjedhje\\_.pdf?fbclid=IwAR3IGVs\\_xQlgZMF1foVsNNT8tU6NT9wRUh24MnInvSx-8zefiaw8g83tHmQ](https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2019/10/ALB-Padia-civile-lidhur-me-ceshtje-te-diskriminimit-te-grave-n%C3%AB-zgjedhje_.pdf?fbclid=IwAR3IGVs_xQlgZMF1foVsNNT8tU6NT9wRUh24MnInvSx-8zefiaw8g83tHmQ) Padia është refuzuar nga ana e Gjykatës Themelore në Prishtinë, mbi bazën se ajo nuk i specifikon individët konkretë të cilët ishin diskriminuar sipas formulimit të listës zgjedhore. URL: [https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2019/10/Aktvendim-Gjykata-Themelore-n%C3%AB-Prishtin%C3%AB-lidhur-me-masen-e-perkohshme-Padia-civile-lidhur-me-ceshtje-te-diskriminimit-te-grave-n%C3%AB-zgjedhje.pdf?fbclid=IwAR1KIZA DhdvTgTVIOOrMpMNH5ZQEvI6vN7IfCusn47rYFaZ\\_-KbXZB3-Gzrc](https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2019/10/Aktvendim-Gjykata-Themelore-n%C3%AB-Prishtin%C3%AB-lidhur-me-masen-e-perkohshme-Padia-civile-lidhur-me-ceshtje-te-diskriminimit-te-grave-n%C3%AB-zgjedhje.pdf?fbclid=IwAR1KIZA DhdvTgTVIOOrMpMNH5ZQEvI6vN7IfCusn47rYFaZ_-KbXZB3-Gzrc)



Diskutimi rreth kuotës gjinore mbetet problematik, sepse kjo çështje lidhet ngushtë me ndryshimin e vetë strukturës së Kuvendit. Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme përcakton se listat partiake duhet të përmbajnë të paktën 30 përqind gra dhe 30 përqind meshkuj.<sup>6</sup> Veç kësaj, ai po ashtu përcakton se një kandidat i cilësdo gjini duhet të përfshihet të paktën njëherë pas tre kandidatëve të gjinisë tjetër.<sup>7</sup> Pikërisht kjo rregullore ka krijuar hatërmbetje të mëdha mes deputetëve. Së fundmi, saktësisht për shkak të kësaj rregulloreje, një anëtare e Vetëvendosjes, e cila në zgjedhjet e vitit 2019 kishte fituar më shumë vota se kolegët e saj meshkuj, nuk mundi ta sigurojë ulësen në Kuvend.<sup>8</sup> Përkundër numrit më të madh të votave, asaj iu pamundësua sigurimi i ulëses në Kuvend. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) iu dha përparësi deputetëve, në përputhje me radhitjen gjinore të bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. E njëjta çështje ra në sy edhe në rastin e deputetëve.<sup>9</sup> Deputetët të cilët fitojnë më shumë vota shpesh anashkalojnë për t’iu liruar rruga kandidatëve femra. Kjo qasje ka prodhuar debate të politizuara lidhur me meritat e kandidatit të caktuar për t’u bërë deputet i Kuvendit.

Nëse do të ketë lëvizje drejt kuotës prej pesëdhjetë përqind, sikurse theksohet në LBGj, debati do të bëhet edhe më problematik. Deputetët që mund të fitojnë më shumë vota se sa femrat dhe të cilët edhe tani janë nën presionin e humbjes së mandatit të tyre shkak të kuotës, do të hezitojnë ta përkrahin këtë ndryshim me lehtësi.

Ndonëse Kuvendi i ka tridhjetë e nëntë (39) deputete, atyre iu mungon përkrahja e kolegëve meshkuj për të filluar

<sup>6</sup> Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 27 (1)

<sup>7</sup> Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 27 (1)

<sup>8</sup> Kandidatja e Vetëvendosjes, Tinka Kurti, nuk mundi të siguronte një ulëse si zëvendësim në Kuvendin e Kosovës, pasi që deputetët e Vetëvendosjes që radhiteshin para saj u emëruan në poste ekzekutive në Qeverinë Kurti. Megjithëse ajo kishte numër më të madh të votave se sa kolegët e saj meshkuj, KQZ, në përputhje me Nenin 28 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, vendosi që ato mandate t’iu ofrohen deputetëve meshkuj. URL: <https://kallxo.com/lajm/kurti-pret-vendimin-e-gjykates-per-mandatin-e-deputetes/>

<sup>9</sup> Në rastin e deputetit mashkull, i cili i është shmangur lirimit të rrugës për kandidaten femër, është ngritur debat rreth meritave të kandidatëve. Në rastet kur nga deputetët është kërkuar të heqin dorë nga ulëset e tyre, është ngritur debati për efektin restriktiv të kuotës aktuale. Është e qartë se kuota prej 30 përqind ka prodhuar rezultate pozitive, dhe se debati klasik për çështjen e meritokracisë nuk e dëmton ligjshmërinë e kuotës si masë për korrigjimin e jobarazisë historike gjinore.

harmonizimin e kuotës prej 30 përqind – sa është sipas Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme – me kuotën prej 50 përqind, sa parashihet në Ligjin për Barazi Gjinore. Me aq sa duket, një përfaqësim i drejtë e i barabartë politik, në përputhje me LBGj-në, duket shumë vështirë i arritshëm.

Megjithatë, deputetet kanë fuqi të konsiderueshme legjislative për mobilizimin e aspekteve tjera të LBGj-së; duke siguruar se ligjet dhe politikat janë përpiluar në pajtim me vlerësimin e duhur gjinor. Gratë në kuvende komunale dhe ato në Kuvendin e Kosovës kanë mundësi unike që – nëpërmjet disa instrumenteve ligjore që i kanë në dispozicion – ta inaugurojnë vetëveten si mbikëqyrëse legjislative të integritit të perspektivës gjinore në proceset publike politike. Shikuar nga këndvështrimi pragmatik, kjo është mundësi e arritshme, sepse çështja e rritjes së përfaqësimit të grave në Kuvend nuk i nënshtrohet vullnetit politik të drejtuesve meshkuj të partive politike, e as atij të deputetëve. Në fakt, debatet rreth përfaqësimit politik të grave nuk duhen anashkaluar, ndonëse edhe përfaqësueset e grave duhet të ecin drejt një qasjeje më proaktive që garanton se nevojat e femrave adresohen si duhet, qoftë nëpërmjet politikëbërjes lokale apo asaj qendrore.

## ADRESIMI I MANGËSIVE MES GRAVE VENDIMARRËSE TË NIVELEVE TË NDRYSHME TË LEGJISLATIVIT

### Citat

“Ne mund t’a plotësojmë njëra-tjetrën, sepse neve në kuvendet komunale na mungon fuqia për të sjellë vendime. Nëse e fillojmë bashkëpunim me nivelin qendror, atëherë do të kemi gjasa më të mira”

Janë tri pengesa kryesore që e potencojnë dështimin e vazhdueshëm të përfaqësueseve politike të grave për integrimin e çështjeve gjinore, si element kyç për hartimin/ndryshimin e politikave. E para është se ndarja e presupozuar e politikëbërjes qendrore nga ajo lokale ka prodhuar njëloj mosmarrëveshjeje mes përfaqësueseve politike të grave. Kjo, si rrjedhojë, ka ndikuar pastaj në vullnetin e përfaqësueseve lokale për adresimin e çështjeve bashkë me deputetet (dhe ansjelltas.)<sup>10</sup> E dyta është se përfaqësueset politike të grave thjesht nuk i shfrytëzuan mekanizmat ekzistues për sigurimin

<sup>10</sup> Diskutimi rajonal i Grupit për Ballkan me përfaqësueset e zgjedhura të grave, janar 2020

e përfshirjes së qytetarëve në proceset e politikëbërjes. Kuvendet komunale vazhdojnë të dështojnë në përmbushjen e standareve ligjore (ose t'i përmbushin ato vetëm minimalisht) për sigurimin e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje.<sup>11</sup> E treta është se, përderisa legjislativi i mbikëqyrë proceset ligjvënëse (lokale dhe qendrore), përfaqësueset politike të grave nuk e monitoruan plotësisht implementimin e ligjeve. Janë veçanërisht disa aspekte të LBGj-së (si p.sh. integrimi i perspektivës gjinore në të gjitha ligjet, të dhënat e zbërthyer mbi baza gjinore, etj.) që mbesin të paimplementuara në institucionet e shumta publike.<sup>12</sup> Pa një shqyrtim të duhur të implementimit të integritimit të perspektivës gjinore dhe pa adresimin me kohë të tij, as miratimi nga ana e institucioneve publike nuk mund të realizohet plotësisht.

**Citat**

“Nëse niveli qendror nuk është më i rreptë në kërkimin e informatave nga niveli lokal, niveli lokal s’do të mund t’i plotësojë kërkesat. Problemi nuk ka të bëjë vetëm me punësimin, por edhe me pozitat

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Propozimi dhe amandamentimi i akteve komunale që krijojnë mekanizma lokalë për implementimin e legjislacionit që aplikohet në nivel qendror;</li> <li>- Krijimi i komisioneve ndihmëse dhe këshillëdhënëse me pjesëmarrje të qytetarëve, të cilat mund të japin propozime, të bëjnë hulumtime dhe të shprehin mendime për nisma komunale;</li> </ul>
Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Angazhimi në politikat e qeverisjes lokale, nëpërmjet pjesëmarrjes të autoriteteve të qeverisjes lokale në takime/diskutime/iniciativa;</li> <li>- Kërkesa për shqyrtim të menjëhershëm me ministrinë dhe ministrat sektorialë të çështjeve që ndërlidhen me proceset politike (si p.sh. me ligjvënien që ndërlidhet me autorizimet specifike të ministrive)</li> </ul>
Ligji për Barazi Gjinore	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Integrimi i perspektivës gjinore në të gjitha politikat, dokumentet dhe në legjislacion;</li> </ul>

Këto çështje vazhdojnë të jenë pengesë e madhe për aplikimin e plotë të integritimit të perspektivës gjinore, si praktikë themelore për hartimin e ligjeve dhe politikave. Përkundër

<sup>11</sup> Ligji për Vetëqeverisjen Lokale përcakton mbajtjen e të paktën dy takime të nivelit lokal me qytetarë brenda një viti. Sipas ‘Raportit të Funkcionalitetit Komunal për vitin 2020’, të Ministrisë së Pushtetit Lokal (MPL), janë gjithsej 22 komuna të cilat nuk i kanë mbajtur fare takimet (e kërkuara) periodike me qytetarë.

<sup>12</sup> Rrjeti i Grave të Kosovës, “Analiza Gjinore e Kosovës”, 2018. URL: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/womens-network.pdf>

## Citat

“Në seancat dëgjimore për buxhet problem është pjesëmarrja e grave, sepse pjesëmarrja e tyre është tejte e ulët”

natyrës së këtij joefikasiteti, ekzistojnë disa instrumente ligjore të cilat përfaqësueset e grave mund t'i përdorin për adresimin e drejtpërdrejtë të mangësive që u përmendën më sipër. Janë veçanërisht Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit dhe Ligji për Barazi Gjinore ato që i definojnë qartë kornizat e ndryshme rregulluese që mund të përdoren për avancimin e hartimit të një politikëbërje të përgjegjshme gjinore në Kosovë.

**Ligji për Vetëqeverisjen Lokale** e përcakton kornizën e përgjithshme për rolin e kuvendeve komunale në qeverisjen demokratike të komunave. Pasi komunat posedojnë fuqi ekzekutive për organizimin e një numri të politikave sektoriale, duke filluar nga ato të zhvillimit ekonomik, sigurimit të arsimit, shëndetësisë dhe shërbimeve të mirëqenies sociale, e deri tek promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, anëtarët e kuvendeve komunale kanë rol të rëndësishëm për të siguruar se politikat lokale do të jenë gjithëpërfshirëse.<sup>13</sup> Ndoshta aspekti më i rëndësishëm i indentifikuar në Ligj është nocioni i demokracisë së drejtpërdrejtë dhe i pjesëmarrjes qytetare.<sup>14</sup> Këto dispozita plotësohen me mandatin e Ministrisë së Pushtetit Lokal (MPL) për të siguruar implementimin e politikave që kanë për synim rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimarrje.<sup>15</sup>

Si të tilla, kuvendet komunale kanë mandat të adoptojnë dhe implementojnë vendime që përputhen me nevojat e qytetarëve.<sup>16</sup> Ligji iu ofron komunave (dhe anëtarëve të tyre) një sërë instrumentesh që mund të përdoren për të siguruar se gjatë hartimit të akteve komunale nevojat/kërkesat e qytetarëve janë trajtuar si duhet.<sup>17</sup> Ç'është më e rëndësishmja, takimet periodike publike dhe komisionet këshillëdhënëse janë mjetet kyçe që mund të shfrytëzohen nga anëtarët e kuvendeve komunale

<sup>13</sup> Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Neni 17

<sup>14</sup> Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Neni 39

<sup>15</sup> Rregullorja e Qeverisë Nr. 05/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të Ministrive, Shtojca 13

<sup>16</sup> Sipas Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Publikimin e Akteve Komunale, kuvendet komunale kanë kompetenca të drejtpërdrejta për hartimin e statuteve, rregullave dhe procedurave të kuvendit, vendimeve, rregulloreve dhe akteve të tjera të përgjithshme, për aprovimin e buxheteve komunale, themelimin e komisioneve të përhershme, komisioneve konsultative, si dhe të komisioneve të tjera.

<sup>17</sup> Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Neni 68 për Informim Publik dhe Konsultime, dhe Neni 73 për Komisione Këshillëdhënëse.

për t'u siguruar se qytetarët janë të përfshirë në proceset e vendimmarrjes që ndërlidhen me politika të ndryshme sektoriale.<sup>18</sup>

**Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit** i sqaron mundësitë ligjore që mund t'i përdorin deputetët e nivelit qendror për shqyrtimin dhe ngritjen e nivelit të llogaridhënies së autoriteteve dhe vendimmarrësve lokalë. Nga deputetët kërkohet të shërbejnë si ndërmjetës mes autoriteteve lokale dhe qendrore për adresimin e mangësive në vendimmarjen legjislative. Në raport me autoritetet lokale, deputetët kanë të drejtë të marrin pjesë rregullisht në takimet e organizuara nga autoritetet lokale.<sup>19</sup> Përveç kësaj, nga autoritetet lokale kërkohet që deputetëve t'ua sigurojnë kalendarin e sesioneve në fillim të secilit muaj.<sup>20</sup> Ky mekanizëm mundëson që deputetët e nivelit qendror të kenë qasje të drejtpërdrejtë në informacionet mbi politikëbërjen lokale dhe pikëpamjet e saj.

Në nivel qendror, deputetët kanë të drejta të ngjashme në raport me autoritetet ekzekutive qendrore. Krerët e institucioneve (respektivisht të ministrive) kanë obligim t'i "mirëpresin [deputetët] me prioritet, në çfarëdo kohe që ata kërkojnë takim rreth problemeve që ndërlidhen me realizimin e detyrave të tyre."<sup>21</sup> Këto takime mund t'i shërbejnë qëllimit, për përfshirjen e deputetit në debatet e drejtpërdrejta me ministra "lidhur me përmbushjen e detyrave të tyre, të ministrisë, apo edhe të secilit institucion të administratës shtetërore të pushtetit lokal."<sup>22</sup> Ky mekanizëm ligjor u ofron deputetëve një mundësi të rëndësishme për kontrollimin e kompatibilitetit të hartimit të politikave legjislative mes nivelit lokal dhe atij qendror.

*Citat*

“Problem është pjesëmarrja e ulët e qytetarëve në konsultimet publike, dhe pjesëmarrja edhe më e ulët e grave”

<sup>18</sup> Ligji Nr. 03/ L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Neni 68 për Informim Publik dhe Konsultime përcakton se “secila komunë duhet të mbajë takime periodike publike, të paktën dy herë në vit, në të cilat mund të marr pjesë çdo person ose organizatë që ka interesim për komunën.” Neni 73 për Komisione Këshillëdhënëse përcakton se “Kuvendi komunal duhet të themelojë komisione këshillëdhënëse brenda sektorëve, me qëllim që qytetarëve t’iu mundësohet pjesëmarrja në procesin e vendimmarrjes.” “Komisionet këshillëdhënëse mund të dorëzojnë propozime, të kryejnë hulumtime dhe të japin mendime rreth iniciativave të kuvendeve komunale, në përputhje me Statutin e Komunës.”

<sup>19</sup> Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Neni 12 (1)

<sup>20</sup> Ibid, Neni 12 (2)

<sup>21</sup> Ibid, Neni 13 (1).

<sup>22</sup> Ibid, Neni 13(2).

*Citat*

“Të praktikohen politikat në bazë të të dhënave. Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor duhet të bëhet përmes të dhënave të zërthyera mbi baza gjinore, ashtu që ai vërtet të ketë bazë gjinore”

**Ligji për Barazi Gjinore** i përcakton standardet e përgjithshme ligjore që e rregullojnë integrimin gjinor. Siç u tha më lartë, ligji i përcakton rregullat politike (kuotën prej pesëdhjetë përqind për përfaqësim politik) dhe ato të nivelit politik që synojnë rritjen e nivelit të barazisë gjinore.<sup>23</sup> Të gjitha rregulloret e nivelit politik kanë qëllim të sigurojnë se “gjatë të gjitha planifikimeve, buxhetimeve dhe implementimit të akteve nga entitetet publike ose private janë aplikuar parimet e barazisë gjinore dhe të integritit të perspektivës gjinore.”<sup>24</sup> Për t’u siguruar kjo, nga institucionet e të gjitha niveleve, përfshirë legjislativin, kërkohet se politikat/veprimet do të implementohen në përputhje me masat e përgjithshme si në vijim:

- Integrimi i perspektivës gjinore në të gjitha politikat, dokumentet dhe në legjislacion;
- Përfshirja e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një mjet i domosdoshëm për garantimin e respektimit të parimit të barazisë gjinore gjatë mbledhjes, shpërndarjes dhe alokimit të mjeteve;
- Të gjitha të dhënat dhe informacionet e mbledhura statistikore duhet të shënohen, regjistrohen, përpunohen mbi baza gjinore, dhe pastaj duhet të jetë obligative që t’i dërgohen Agjencisë së Statistikave të Kosovës<sup>25</sup>;

Këto masa janë kërkesa ligjore të cilat individët/institucionet në pozita vendimmarrëse duhet t’i marrin parasysh gjatë hartimit të politikave. Në rastin e legjislacionit lokal dhe atij qendror, përfaqësuesit e zgjedhur duhet të jenë të kujdesshëm dhe të sigurojnë mbikëqyrje efikase për shfrytëzimin e këtyre masave të përgjithshme, siç definohet në LBGj.

<sup>23</sup> LBGj-ja i dallon dy lloje të masave për parandalimin e diskriminimit gjinor dhe për arritjen e barazisë gjinore: të përgjithshme dhe të veçanta. Masat e përgjithshme shihen si mekanizma të nivelit politik që kërkojnë institucione (legjislative, ekzekutive, judike, dhe insitucione tjera publike) për të ruajtur punën e tyre të përditshme për t’u siguruaruar se integrimi i perspektivës gjinore shndërohet në de facto procedurë operative. Masat e veçanta shihen si mekanizmat të përkohshëm, në disa raste nëpërmjet veprimeve afirmative, për përsheptimin e barazisë mes meshkujve dhe grave në fusha të ndryshme sociale dhe politike.

<sup>24</sup> Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, Neni 4 (4).

<sup>25</sup> Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, Neni 5.

Instrumentet dhe mekanizmat ligjorë në këto tri ligje përfaqësuese të zgjedhura të grave u ofrojnë mundësi të shumta për rritjen e nivelit të aplikimit të integritit të perspektivës gjinore gjatë të gjitha fazave të politikëbërjes. Thënë më konkretisht, këto veçori mund të përdoren për të ndikuar drejtpërsëdrejti në nevojën e integritit të perspektivës gjinore në 1) përfaqësim, 2) pjesëmarrje publike në politikëbërje dhe 3) në mbikëqyrje legjislativë.

## SIGURIMI I PËRFAQËSIMIT EFIKAS

Sistemi zgjedhor në Kosovë ua lejon qytetarëve zgjedhjen e përfaqësuesve të vet në nivel lokal dhe qendror. Votuesit i zgjedhin përfaqësueset e grave në kuvendin qendror dhe organet qeverisëse lokale mbi bazë të kuotës prej tridhjetë përqind.<sup>26</sup> Kjo kornizë njëfarë mënyre e promovon mungesën e bashkëpunimit ndërmjet grave të zgjedhura në kuvendet komunale dhe atyre në Kuvendin e Kosovës. Një dukuri e tillë është rrjedhojë e asaj se të dy këto grupe fokusohen dhe punojnë ekskluzivisht vetëm për nivelin (qoftë ai lokal apo qendror) të cilin janë zgjedhur ta përfaqësojnë. Ndonëse kjo është e pritshme, megjithatë kërkohet një përpjekje më e koordinuar e tyre për të siguruar se nevojat e qytetarëve të nivelit lokal janë adresuar edhe nga ana e politikëbërësve relevantë në nivel qendror.

Kështu si është, ekziston një mungesë e madhe e adresimit të nevojave të qytetarëve dhe ka pak përpjekje për fuqizimin e rolit të grave që i adresojnë ato. Anëtarët e kuvendeve komunale thonë se deputetet dështuan që të përfshiheshin në zgjidhjen e problemeve lokale. Një pjesë e kësaj bindjeje i atribuohet besimit se, sapo të jenë bërë pjesë e Kuvendit deputetet përqendrohen vetëm në hartimin e ligjeve të nivelit qendror.<sup>27</sup> Nga ana tjetër, deputetet sikur hezitojnë të merren me këto shqetësime dhe dështimet në fjalë ia atribuojnë mosangazhimit të përfaqësuesve lokale për adresimin e çështjeve relevante në kuvendet ku ato veprojnë.<sup>28</sup> Në të vërtetë, të dy grupet janë treguar të paaftra në adresimin e çështjeve relevante në vendet

### Citat

“Në fushën e buxhetimit gjinor ne kërkojmë një shtytje nga niveli qendror atëherë kur komunat nuk e zbatojnë një buxhetim të përgjegjshëm, që është detyrim i tyre ligjor. Deputetet në nivel qendror duhet ta nxisin Ministrin e Financave që të mos i aprovojë buxhetet për komunat që nuk i përmbushin kërkesat për një buxhetim të përgjegjshëm gjinor”

<sup>26</sup> Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 27 (1)

<sup>27</sup> Diskutimi Rajonal i Grupit për Ballkan me Gratë e Zgjedhura Përfaqësuese, janar 2020

<sup>28</sup> Ibid, janar 2020

përkatëse të politikëbërjes, gjithashtu, kanë bërë pak përpjekje që të përdorin instrumentet në dispozicion për të ndikuar në politikëbërje.

Diskutimet e vazhdueshme për sistemin zgjedhor shpesh sugjeronin se ndarja e zonave zgjedhore do të prodhonte një përfaqësim më të ndërgjegjshëm, ku popullata lokale (gratë) do të kishte mundësi të zgjedhte përfaqësuesen nga zona e vet, e cila do t'i përfaqësonte drejtpërdrejtë nevojat dhe interesat e tyre në nivel qendror. Por, edhe sistemi aktual për zgjedhjen e përfaqësuesve në të dy nivelet mund të jetë po aq i efektshëm, nëse roli i përfaqësueseve të zgjedhura (në të dy nivelet) do të shfrytëzohej në mënyrë më efikase.

Përdorimi efikas dhe gjithëpërfshirës i kompetencave brenda organeve legjislativë lokale dhe qendrore është i domosdoshëm për integrimin efikas gjinor. Si përfaqësuese lokale, anëtarët e kuvendeve komunale kanë kompetenca direkte për orientimin politik të akteve komunale.<sup>29</sup> Në kuadër të fushëveprimit të ligjeve ekzistuese, aktet komunale vetëm sa e plotësojnë implementimin e legjislacionit në nivel lokal.<sup>30</sup> Rrjedhimisht, anëtarët e një kuvendi të caktuar komunal mund ta mobilizojnë përkrahjen politike, për të siguruar kështu integrimin gjinor në aktet komunale.<sup>31</sup> Një shembull i qartë i këtij pohimi është amandamentimi i rregulloreve komunale të vitit 2017, në komunat e Istogut dhe Deçanit.<sup>32</sup> Anëtarët e Kuvendit Komunal të Deçanit u mobilizuan për adresimin e çështjes së pabarazisë gjinore nëpër rregullore, përmes përcaktimit të kuotës 50 përqindëshe të pjesëmarrjes së grave në komisione, dhe të asaj

#### Citat

“Kur ke të dhëna të sakta është shumë më lehtë të vazhdohet bashkëpunimi në nivel sektorial”

<sup>29</sup> Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Neni 39 OSBE “Marrëdhëniet ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj lokale: Aktet komunale,” (Relationships between Central and Local Government: Municipal Acts), shtator 2009 URL: <https://www.osce.org/kosovo/67462?download=true>

<sup>30</sup> Rregullorja (MPL) Nr. 01/ 2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës precizon se aktet komunale përfshijnë: statutet, rregulloret, vendimet dhe urdhëresat. Sipas nenit 13, propozuesit e akteve normative komunale mund të përfshijnë: njësitë e mëdha dhe administrative komunale, udhëheqësit e kuvendeve komunale, komisionet e kuvendeve komunale, anëtarët e kuvendeve komunale dhe pesëmbëdhjetë (15) përqind të qytetarëve të komunës respektive me të drejtë vote.

<sup>31</sup> Rrjeti i Grave të Kosovës, raporti i vitit 2018 “Analiza Gjinore e Kosovës” nënvizon se një pjesë e madhe e legjislacionit primar dhe sekondar të Kosovës nuk e përmban fare perspektivën gjinore. URL: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20181003170921410.pdf>

<sup>32</sup> Syri i Vizionit “Kuvendet komunale ndryshojnë tri rregullore për të ofruar barazinë gjinore” URL: <https://www.syriivizionit.org/?page=1,58,583>



prej tridhjetë (30) përqind për pjesëmarrjen e grave në këshillat lokalë.<sup>33</sup> Ky veprim dëshmon se përfaqësueset politike të grave në nivel lokal posedojnë fuqi të konsiderueshme dhe se mund të kenë rol të rëndësishëm në adresimin e çështjes së pabarazisë gjinore nëpërmjet amandamentimit ose propozimit të akteve komunale.

Në bazë të Rregullores për Procedurat e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, përfaqësueset mund të propozojnë rregullore për lehtësimin e procesit të mbledhjes së të dhënave mbi baza gjinore nëpër drejtoratet komunale, në mënyrë që të njëjtat të shërbejnë si analiza gjithëpërfshirëse gjinore. Për ta kompletuar përfaqësimin e tyre, deputetet e Kuvendit të Kosovës mund të angazhohen drejtpërdrejt në politikat e qeverisjes lokale përmes pjesëmarrjes në takimet e autoriteteve të qeverisjes lokale.<sup>34</sup> Nëse përdoret në mënyrë efikase, ky veprim mund t'iu mundësojë përfaqësueseve takime të rregullta për shqyrtimin e pasojave të integritit të perspektivës gjinore brenda aktiviteteve të qeverisjes lokale. Si rrjedhojë, deputetet pastaj mund t'i kanalizojnë ato njohuri nëpërmes konsultimeve të drejtëpërdrejta me ministritë apo ministrat përgjegjës, dhe të ofrojnë hapa konkret për avancimin e legjislacionit sektorial. Dështimi i ndërmarrjes së këtyre hapave mund të vërehet qartë në rastin e shëndetësisë.

Gjatë identifikimit të prioriteteve, Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017–2021, e Qeverisë së Kosovës, dështoi në mbulimin e nevojave lokale dhe gjinore.<sup>35</sup> Anëtarët e kuvendeve komunale dhe deputetet mund të përfshihen në përmirësimin

Citat

“Anëtarët e Kuvendit duhet të bëjnë presion në drejtoritë përkatëse për mbledhjen e të dhënave mbi baza gjinore, të cilat nga ana tjetër duhet që nëpërmjet deputetëve t'i shtyjnë ministritë e caktuara të mbledhin të dhëna mbi baza gjinore me qëllim që të ndikojnë në politikat përkatëse”

<sup>33</sup> Rregullorja e Komunës së Deçanit për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime dhe vende fqinje brenda territorit të Komunës së Deçanit dhe Rregullorja për amandamentimin e rregullores komunale për punë të Komisionit për emërimin, riemërimin e shesheve, rrugëve, bulevardëve dhe vendeve të tjera publike.

<sup>34</sup> Ligji Nr.03/ L-III pr të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Neni 12

<sup>35</sup> Ministria e Shëndetësisë, “Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë”, nëntor 2019 URL: [http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia-sektoriale-e-shendetesise-final-nentor-2016-ALB\\_.pdf](http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia-sektoriale-e-shendetesise-final-nentor-2016-ALB_.pdf) The strategy's background discussion features no identification of (health) policy discussion either a focus on a local or gender perspective. A clear example of this is the discussion on 'mental health', either no analysis at all on local-specific issues and gender ramifications. This trend follows throughout the policy discussion on the background of prominent national health issues. Most notably, analysis on health priorities and the subsequent mid-term objectives are not structured and based along gender dis-aggregated data findings.

e kësaj strategjie, por edhe të dokumenteve tjera strategjike politike qendrore e lokale, nëpërmjet integritit të perspektivave gjinore në to. Në rastin e shërbimit shëndetësor lokal, Drejtorati Komunal i Shëndetësisë pastaj do të ishte i obliguar (në përputhje me kërkesat e LBGj-së) që t'i mbledhë të dhënat e zberthyer mbi indikatorët e ndryshëm shëndetësorë brenda komunës. Veç kësaj, gjatë diskutimeve me ministritë përgjegjëse deputetët që i shfrytëzojnë këto gjetje komunale do të mund t'i përkrahin përparësitë specifike lokale dhe gjinore. Si rezultat, strategjitë qendrore sektoriale (si p.sh. Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë) do të përfitonin jashtëzakonisht shumë nga integrimi i këndvështrimeve lokale e gjinore gjatë hartimit të prioriteteve politike afatmesme dhe afatgjata. Kjo dëshmon se si një shtytje e duhur (krahas ekzistimit të vullnetit politik) e përfaqësueseve politike të grave në nivel lokal dhe qendror mund të prodhojë strategji shumë më gjithëpërfshirëse.

## **PJESËMARRJA E PUBLIKUT NË HARTIMIN E LIGJEVE DHE POLITIKAVE**

Sigurimi i kushteve të nevojshme për pjesëmarrjen e qytetarit (gruas) në proceset publike politike është veprimi domosdoshëm për arritjen e integritit të qëndrueshëm gjinor. Pa dyshim se politikat nuk mund të jenë gjithëpërfshirëse nëse proceset konsultative nuk përmbajnë këndvështrime të ndryshme, përfshirë ato gjinore. Stereotipet gjinore dhe padrejtësitë sistematike jo vetëm që i pengojnë zhvillimet pozitive sa i përket pjesëmarrjes së grave, por edhe i përkeqësojnë ato shkaku i dështimit të institucioneve dhe përfaqësueseve politike të grave për përdorimin e efektshëm të mekanizmave ekzistues të pjesëmarrjes.<sup>36</sup> Mbetet në diskrecionin e tyre që të avokojnë për kushte më të favorshme për pjesëmarrjen e grave në konsultimet publike. Kjo, megjithatë nuk po ndodhë sepse grupet joformale të grave në nivel lokal pretendojnë se iu mungojnë mjetet themelore.<sup>37</sup>

### *Citat*

“Ka mekanizma të ndryshëm që mund të përdoren për t’iu shërbyer ligjeve ekzistuese”

<sup>36</sup> Rrjeti i Grave në Kosovë, “Analiza Gjinore e Kosovës” 2018 URL: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/womens-network.pdf>

<sup>37</sup> Diskutimi Rajonal i Grupit për Ballkan me Gratë e Zgjedhura Përfaqësuese, janar 2020

Përkundër faktit se ky pohim qëndron, mjetet financiare nuk janë të domosdoshme për adresimin e kësaj çështje.

Rregullorja e Qeverisë për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik e përcakton kornizën e përgjithshme për sigurimin e pjesëmarrjes publike në konsultimet politike.<sup>38</sup> Rregullorja nënvizon se të gjitha organet publike janë përgjegjëse për implementimin e formave efikase të konsultimeve publike gjatë “hartimit të ligjeve dhe politikave.”<sup>39</sup> Si përfaqësues të nevojave të qytetarëve, nga përfaqësuesit politikë kërkohet që të sigurohen se propozimet serioze politike janë përmbushur përmes shqyrtimit të domosdoshëm publik. Politikat sektoriale, si të tilla – kudo që integrimi i çështjeve gjinore është i nevojshëm – kërkojnë një mobilizim të shtuar të përfaqësueseve politike, për t’u siguruar se në konsultimet publike ekziston një pjesëmarrje e barabartë e meshkujve dhe femrave. Meqenëse organet publike kanë përgjegjësi ligjore për sigurimin e kushteve të duhura për pjesëmarrjen e publikut, deputetet duhet të jenë më proaktive në promovimin e përfitimeve të grave në raport me politikat sektoriale.

Anëtarët e kuvendeve komunale mund të përdorin në mënyrë të barabartë rolin e tyre vendimmarrës.<sup>40</sup> Ata mund të mobilizohen për t’u siguruar se grave u janë ofruar mundësitë e domosdoshme për pjesëmarrje në konsultimet publike. Me krijimin e grupeve joformale të grave nëpër kuvendet e shumta komunale – me mandat të ngjashëm sikurse Grupi i Grave në Kuvend – ato mund të sigurohen se qytetarëve (grave) u janë krijuar kushte të favorshme për pjesëmarrje në takimet publike. Sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, kuvendet komunale kanë kompetenca për themelimin e ‘komisioneve këshillëdhënëse’

*Citat*


“Nuk ekziston një monitorim produktiv i ligjeve”

<sup>38</sup> Rregullorja (GRK) Nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik

<sup>39</sup> Rregullorja (GRK) Nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik

<sup>40</sup> Në vitin 2018, Ministria e Pushtetit Lokal (MPL) ka lëshuar një Udhëzim Administrativ (UA) për standardet minimale të konsultimeve publike në komuna. Qëllimi i UA ishte “promovimi dhe sigurimi i pjesëmarrjes së qytetarëve dhe grupeve tjera të interesit nga ana e autoriteteve lokale të nivelit lokal të politikëbërjes dhe vendimmarrjes, promovimi i transparencës komunale, si dhe ndikimi në zhvillimin e politikave të qëndrueshme me interes të përgjithshëm.” Në përputhje me Rregulloren e Qeverisë për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik, kjo UA synon të krijojë të njëjtat kushte të nevojshme për konsultime publike brenda organeve komunale.

sektoriale, qëllimi i të cilave është “mundësimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.”<sup>41</sup> Po ashtu, këto komisione mund “të dorëzojnë propozime, kryejnë hulumtime dhe japin mendime” lidhur me çështjet që i përkasin domenit të politikave sektoriale.<sup>42</sup> Anëtarët e kuvendeve komunale dhe grupet e tyre joformale mund të ndikojnë në atë që përdorimi i këtij instrumenti të ndikojë drejtëpërsëdrejti në ndryshim, nëpërmjet propozimeve për integrimin e perspektivës gjinore në politikat specifike sektoriale të një komune.



#### Citat

“Kuvendet komunale janë shumë të rëndësishme për identifikimin e problemeve. Është shumë me rëndësi që gratë e nivelit lokal dhe qendror të bëhen bashkë, ngase thelbi i problemeve buron nga niveli komunal”

**Numri i komisioneve këshillëdhënëse të themeluara në komuna të ndryshme në vitin 2019; marrë nga “Raporti i funksionimit të komunave” i Ministrisë së Pushtetit Lokal (MPL)<sup>43</sup>**

Që nga viti 2017 ka pasur rritje të konsiderueshme të numrit të komisioneve këshillëdhënëse nëpër komuna. Përderisa në vitin 2017 ishin 27, në vitin 2018 ishin 30, ndërkaq viti 2019 rezultoi me rritjen më të madhe, me 43 komisione këshillëdhënëse që shtriheshin në 16 komuna të ndryshme.<sup>44</sup> Ky ishte ndryshim pozitiv i përfshirjes ndër vite të qytetarëve në hartimin e politikave në nivel lokal. Shumica e komisioneve këshillëdhënëse

<sup>41</sup> Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale

<sup>42</sup> Ibid

<sup>43</sup> Qeveria e Kosovës, Ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal, “Raporti i funksionimit të komunave të Republikës së Kosovës, janar-dhjetor 2019” URL: <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/03/3.-Report-on-the-functioning-of-the-municipalities-of-the-Republic-of-Ko....pdf>

<sup>44</sup> Qeveria e Kosovës, Ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal “Raporti i funksionimit të komunave të Republikës së Kosovës, janar-dhjetor 2017” Qeveria e Kosovës, Ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal “Raporti i funksionimit të komunave të Republikës së Kosovës, janar-dhjetor 2018” Qeveria e Kosovës, Ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal “Raporti i funksionimit të komunave të Republikës së Kosovës, janar-dhjetor 2019”

(dhe ndihmëse) faktikisht u themeluan për trajtimin e çështjeve sektoriale, si zhvillimi ekonomik, shërbimet publike, arsimi, etj.<sup>45</sup>

Figura 2. Fushat e mbuluara nga komisionet këshillëdhënëse në vitin 2019; marrë nga "Raporti i funksionimit të komunave" i Ministrisë së Pushtetit Lokal (MPL)





Figura 3. Komisionet tjera (ndihmëse) të themeluara në vitin 2019, marrë nga "Raporti i funksionimit të komunave", i Ministrisë së Pushtetit Lokal (MPL)



Në vitin 2019 nuk ka pasur komisione këshillëdhënëse apo ndihmëse që kanë trajtuar çështje gjinore. Nga ana tjetër, në vitin 2017 ekzistonin dy komisione këshillëdhënëse që merreshin me trajtimin e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore, si dhe katër komisione ndihmëse që trajtonin vetëm barazinë

<sup>45</sup> Përveç themelimit të komisioneve këshillëdhënëse, të identifikuara në Ligjin Nr. 03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, MPL ka lëshuar një UA me Nr. 02/2018 për Amandamentimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 03/2014 për procedurat e themelimit, përbërjes dhe autorizimeve të komisioneve komunale në fuqi. UA nënvizon se "komuna mund të themelojë komisione shtesë, në varësi nga nevojat e përmbushjes së përgjegjësisve në sektorin respektiv."

gjinore.<sup>46</sup> Anëtarët e kuvendeve komunale mund ta adresojnë drejtpërsëdrejti këtë mospërputhje, përmes mbështetjes së themelimit të komisioneve të reja këshillëdhënëse (ndihmëse), të cilat do të merreshin me barazi gjinore. Shkaku i mungesës së mjeteve (financiare) për grupet joformale të grave, komisionet këshillëdhënëse (dhe ndihmëse) mund të luajnë një rol më të madh për rritjen e përfshirjes dhe diskutimit të çështjeve gjinore gjatë konsultimeve publike. Grupet joformale të grave në nivel lokal (dhe gratë anëtare të kuvendeve komunale në përgjithësi) mund të mobilizohen dhe të hartojnë propozime për themelimin e komisioneve këshillëdhënëse dhe ndihmëse, të cilat do të merreshin ekskluzivisht me barazi gjinore. Nga ana tjetër, këto komisione mund edhe të nxjerrin propozime të duhura që përmes integritit të perspektivës gjinore do të ndikonin në trajektoren e politikave sektoriale. Shembull i mirë për këtë pohim do të ishte themelimi i komisioneve këshillëdhënëse për barazi gjinore, ku grupet e grave lokale, krahas pjesëmarrjes së grave në komisionet lokale, do të mund t'i identifikonin një numër çështjesh politike që kërkojnë trajtim.

Një komision këshillëdhënës për barazi gjinore mund të trajtojë një sërë politikash sektoriale në të cilat gratë, në kontekstin lokal, përballen me diskriminim, si p.sh: qasja e vajzave në arsim, qasja e grave në shërbimet e duhura shëndetësore për lehona dhe foshnje, dhuna mbi baza gjinore dhe investimet për luftimin e papunësisë së grave.<sup>47</sup> Si i tillë, komisioni këshillëdhënës për barazi gjinore përfaqësueseve të grave do t'iu shërbente si platformë efikase për diskutimin dhe rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve (grave) në identifikimin e mangësive të politikave. Rrjedhimisht, komisionet këshillëdhënëse janë të domosdoshëm për hartimin e politikave që problemet lokale mund t'i adresojnë në mënyrë efikase dhe gjithëpërfshirëse.

#### Citat

“Aktivizmi nga niveli lokal ka shpalosur politika të cilat e kanë avancuar rolin e grave. Po të ekzistonte bashkëpunimi me gratë deputete situata do të përmirësohej edhe më tepër”

<sup>46</sup> Në mars 2020 MPL publikoi edicionin “Shqyrtimi i Funksionalitetit Komunal”, edhe pse aty mungojnë të dhënat për aspekte të ndryshme (përfshirë numrin e komisioneve këshillëdhënëse), për shkak se komunat nuk i dërguan ato në MPL.

<sup>47</sup> Perspektiva gjinore mund të integrohet edhe në fushat që rrallëherë mendohet se janë diskriminuese ndaj grave, si: p.sh investimet kapitale. Komisionet këshillëdhënëse për barazi gjinore mund të filtrojnë një sërë politikash sektoriale nëpërmjet prizmit gjinor, në mënyrë që të sigurohet se janë marrë parasysh nevojat dhe të drejtat themelore të qytetarëve.

## MONITORIMI I LEGJISLATIVIT EKZISTUES

Mobilizimi i autorizimeve mund të jetë efikas vetëm kur bëhet i obligueshëm dhe kur shoqërohet me mbikëqyrje dhe monitorim të fuqishëm të implementimit të integritit të perspektivës gjinore. Mbikëqyrja e legjislativit luan një rol tejet të rëndësishëm në sigurimin e zbatimit të standardeve ligjore të përcaktuara me LBGj dhe që ato të përfshihen në punën e institucioneve publike.<sup>48</sup> Sukseset e përfaqësimit efikas dhe të pjesëmarrjes së publikut varen nga mbikëqyrja e legjislativit. Një shembull i qartë i mungesës së integritit të perspektivës gjinore dhe mbikëqyrjes së implementimit ishte rasti i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor (BPGj).<sup>49</sup> Institucionet qendrore dhe organet komunale vazhdojnë të mos e përfillin zërthimin e të dhënave mbi baza gjinore dhe identifikimin e intervenimeve mbi po këto baza, në pajtim me LBGj-në.<sup>50</sup>

Në nivel qendror, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione mund të luaj një rol të rëndësishëm dhe të mbikëqyrë implementimin e integritit të perspektivës gjinore. Komisionet parlamentare nuk janë përgjegjëse vetëm për trajtimin e detyrave të caktuara nga Kuvendi i Kosovës, por mund të marrin përsipër edhe punë tjera brenda kompetencave që i kanë të definuara në Rregulloren e Punës.<sup>51</sup> Duke marrë parasysh bashkëpunimin e komisioneve me Institucionin e Ombudspersonit (IO), gratë deputete duhet të kenë një rol më të fuqishëm për të siguruar se rekomandimet e IO-së po adresohen dhe implementohen. Kjo jo vetëm që siguron se rekomandimet e IO-së për integritin e perspektivës gjinore po institucionalizohen, por edhe u lejon deputeteve që – nëpërmjet komisionit – t'i hartojnë veprimet shtesë që duhen ndërmarrë për adresimin e këtyre çështjeve në bashkëpunim me autoritetet lokale. Në këtë kuptim, komisioni nuk do të shërbej vetëm si mjet i përdorur nga Kuvendi për kryerjen e detyrave specifike, por mund edhe të mobilizohet si instrument

### Citat

“Activism at the local level has introduced policies that improve the role of women. If there is cooperation with women MPs, the situation will improve even more”

<sup>48</sup> Përfshirë legjilativin tjetër që mbron dhe promovon të drejtat e grave (p.sh ligjin kundër diskriminimit, ligjin e punës, ligjin kundër dhunës në familje, etj)

<sup>49</sup> Diskutimi Rajonal i Grupit për Ballkan me Gratë e Zgjedhura Përfaqësuese, janar 2020

<sup>50</sup> Diskutimi Rajonal i Grupit për Ballkan me Gratë e Zgjedhura Përfaqësuese, janar 2020 Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore

<sup>51</sup> Rregullorja e Punës e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Neni 62(1)

i mbështetjes për prodhimin e masave shtesë, të cilat e avancojnë integrimin e perspektivës gjinore.

Nisma e grave deputete përmes Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione mund të jetë e dobishme për plotësimin e punës së anëtarëve të kuvendeve në nivel lokal. Ngjashëm me punën e deputeteve edhe anëtarët e kuvendeve komunale mund të përdorin ndikimin e tyre në komisionet e buxhetit për përkrahjen dhe shtyrjen përpara të një buxhetimi më të mirë dhe të përgjegjshëm gjinor nëpër drejtoritë sektoriale. Shqyrtimet brenda komisionit për buxhet janë esenciale për garantimin që shpenzimet komunale do të jenë në përputhje me standardet ligjore të identifikuara në LBGj-në. Në rast se komunat dështojnë në implementimin e buxhetimit gjithëpërfshirës, të bazuar në mbledhjen e të dhënave mbi baza gjinore, atëherë deputetet mund të ndërhyjnë përmes Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione.

#### Citat

“Është e domosdoshme të shkëmbehen përvojat ndërmjet kuvendeve të komunave të ndryshme, e jo vetëm ato nga rajoni i njëjtë”

Një veprim merëndësi mund të jetë edhe shqyrtimi i sanksioneve nëpër komunat ku mbledhja e të dhënave mbi baza gjinore nuk është realizuar sipas LBGj-së.<sup>52</sup> Deputetet mund të iniciojnë raste të bazuara mbi mungesën e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor (dhe të mbledhjes së të dhënave) në komuna (apo në institucione qendrore), dhe pastaj t'i adresojnë ato përmes Agjencisë për Barazi Gjinore (ABGj).<sup>53</sup> Siç edhe përcaktohet me Rregulloren e Punës të Kuvendit të Kosovës, komisionet janë të autorizuar që t'i ftojnë përfaqësuesit institucional për diskutim/shqyrtim.<sup>54</sup> Komisioni mund të ftojë Ministrin e Financave, kryetarët e komunave ose drejtorët e drejtorive komunale për diskutimin e çështjeve që ndërlidhen me mungesën e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor. Pra, zinxhiri monitorues në nivel lokal mund të prodhojë ndryshime të prekshme, po qe se realizohet në bashkëpunim me deputetet e nivelit qendror.

<sup>52</sup> Ligji për Barazi Gjinore përcakton dispozita ndëshkuese (Neni 23) për rastet kur ka shkelje të dispozitave ligjore. Lidhur me Nenin 5 (i cili përfshin mbledhjen e të dhënave mbi bazë gjinore, si kërkesë ligjore për institucionet publike), ligji nënvizon se: “gjykata kompetente duhet ta zhvillojë procedurën e shkeljes dhe të vendosë sanksione”

<sup>53</sup> Sipas LBGj-së, Agjencia për Barazi Gjinore “bashkëpunon me institucionet publike dhe zyrtarët relevantë për barazi gjinore brenda ministrive dhe komunave, për të siguruar implementimin e dispozitave të parapara me ligjin në fuqi.”

<sup>54</sup> Rregullorja e Punës e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Neni 65(4)



Së këndejmi, monitorimi i implementimit të kërkesave që dalin nga LBGj-ja është thelbi i bashkëpunimit lokal dhe qendror për ta realizuar integrimin e perspektivës gjinore. Zinxhiri monitorues në nivel lokal mund të jetë i dobishëm për nxitjen e mekanizmave të nivelit qendror, të cilat pastaj mund të ndikojnë në ndryshimin e politikave. Mirëpo, kjo mund të funksionoj dhe të prodhoj rezultate vetëm nëse përfaqësueset e grave angazhohen aktivisht në të dy nivelet. Nëse gratë deputete nuk i përmbushin detyrat në mënyrë efikase përmes komisioneve të Kuvendit, atëherë shqetësimet dhe devijimet e evidentuara në nivel lokal mund të mbesin të pandryshuara. Organet komunale (drejtoritë) që nuk mbledhin të dhëna mbi baza gjinore, nuk kanë bazë reale për realizimin e një buxhetimi efikas e të përgjegjshëm gjinor. Në qoftë se anëtarët e kuvendeve komunale nuk i komunikojnë këto shkelje në mënyrë efikase, deputetet nuk do të kenë njohuri për rastet ku kërkohen veprime ligjore. Nga ana tjetër, cikli i mosprioritetizimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor vazhdon ende, për shkak se edhe institucionet lokale dhe ato qendrore po vazhdojnë t'i anashkalojnë kërkesat ligjore që rrjedhin nga LBGj-ja.

Paralelisht, ka nevojë për vetëdijesim më të madh, për ta maksimizuar kështu potencialin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione. Meqenëse barazia gjinore edhe me kushtetutë definohet si premisa themelore e «zhvillimit demokratik të shoqërisë», komisioni duhet të shndërrohet në organ të përhershëm mbikëqyrës; së këndejmi edhe ka nevojë për një shqyrtim serioz të ndryshimit të bazës ligjore të komisionit, nga i përkohshëm në të përhershëm.<sup>55</sup> Ky veprim do të rezultonte me një kontrollë tejet të nevojshme juridike, e cila do të siguronte se të gjitha ligjet i nënshtrohen shqyrtimit adekuat, në kuptimin që të jenë në përputhje me standardet për barazi gjinore.

Nga njëra anë, kushtetuta e definojnë barazinë gjinore si një vlerë themelore që e fuqizon zhvillimin e demokracisë në Kosovë. Nga ana tjetër, LBGj-ja kërkon që integrimi i perspektivës gjinore të jetë përbërësi integral i të gjitha proceseve të politikave publike dhe

<sup>55</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 7(2)

institucioneve. Dështimi i përmbushjes së këtyre standardeve nëpërmes një komisioni me mandat të përhershëm është arsyeja kryesore pse barazia gjinore vazhdon të mbetet një realitet i turbullt. Rolet e Agjencisë për Barazi Gjinore (ABGj) dhe Institucionit të Ombudspersonit (OI) qartazi që nuk mjaftojnë për të siguruar se institucionet publike i përmbahen dispozitave të LBGj-së. Rrjedhimisht, kërkohet që organi më i lartë legjislativ i vendit (Kuvendi i Kosovës) t'ia ndërroj mandatin Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione nga i përkohshëm në të përhershëm, ngase kështu ky komisioni do e rishikonte secilin ligj mbi bazë të drejtave të njeriut dhe të standardeve të barazisë gjinore.

## PËRFUNDIME

Kërkesat për integrimin e perspektivës gjinore, që rrjedhin nga LBGj-ja, vazhdojnë të hasin në pengesa të shumta gjatë implementimit në Kosovë. Gjatë planifikimit të politikave të tyre, institucionet publike dështuan vazhdimisht ta integronin perspektivë gjinore dhe të përmbyllin reformat gjithëpërfshirëse të politikave që bazohen në të dhënat e zbërthyer gjinore. Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet përfaqësuesve politikë të niveleve të ndryshme, përfshirja minimale e qytetarëve në vendimmarrje dhe mungesa e vazhdueshme e monitorimit të integritit të perspektivës gjinore, vazhdojnë të mbesin ndër sfidat më të theksuara që e vonojnë përmbushjen e kërkesave ligjore sipas LBGj-së.

Përfaqësuesit politikë kanë një rol të padiskutueshëm, si agjentë që sjellin ndryshimin institucional të integritit të perspektivës gjinore në gjithë politikëbërjen sektoriale në Kosovë. Përkundër mosefikasitetit aktual, ekzistojnë instrumente të mjaftueshme ligjore - që mund të përdoren nga anëtarët e kuvendeve komunale dhe nga deputetët - përmes të cilave mund të adresohet mungesa e implementimit. Siç dëshmohet shpesh, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji për Barazi Gjinore dhe Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit ofrojnë mjete të vlefshme për përfaqësuesit politikë, për avancimin e gjithëpërfshirjes dhe efikasitetit të politikëbërjes qendrore dhe lokale. Për të siguruar implementimin afatgjatë të integritit të perspektivës gjinore në politikat sektoriale, nga përfaqësuesit politikë kërkohet të angazhohen në ciklin e arritjes së një përfaqësimi efikas, të marrin pjesë në politikëbërje publike, si dhe në monitorimin e legjislacionit ekzistues.

Bashkëpunimi mes anëtareve të kuvendeve komunale dhe deputeteve gjatë hartimit të legjislacionit është jetik për arritjen e një përfaqësimi efikas. Anëtarët e kuvendeve komunale duhet ta përkrahin përfshirjen e perspektivave gjinore në hartimin e politikave lokale. Në rastet kur aktet komunale nuk hartohen

me qëllim të arritjes së barazisë gjinore (si p.sh. rregullimi i mundshëm i procedurave të mbledhjes së të dhënave të zbërthyera mbi baza gjinore), anëtarët e kuvendeve komunale duhet t'i japin përparësi amandamentimit/hartimit të akteve tjera, përmes shtimit të perspektivës gjinore (si në rastet e Istogut dhe Deçanit).

Sigurimi i pjesëmarrjes publike të qytetarëve e plotëson synimin gjithëpërfshirës të politikave. Komisionet këshillëdhënëse dhe takimet periodike me qytetarë mbesin mekanizma relativisht të papërdorur, të cilët mund të kenë ndikim të konsiderueshëm në shkallën e integritit të perspektivës gjinore. Përmes themelimit të komisioneve këshillëdhënëse dhe atyre ndihmëse për «Barazi Gjinore» anëtarët e kuvendeve komunale - në diskutim të ngushtë me qytetarët - mund t'i shqyrtojnë politikat sektoriale të drejtorive komunale karshi implikimeve gjinore që kanë ato në praktikë.

Monitorimi i implementimit të përfaqësimit efikas dhe i pjesëmarrjes së publikut është një proces gjithëpërfshirës që e garanton integritin e qëndrueshëm gjinor në institucionet e niveleve të ndryshme. Siç thuhet qartë në LBGj, integrimi i perspektivës gjinore në Komisionin Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazinë Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione është i një rëndësie jetike në këtë rast. Rëndësia e komisionit – po qe se shndërrohet në të përhershëm - mund të jetë e tejet e rëndësishme për filtrimin e të gjitha proceseve të ligjvënies përmes perspektivës gjinore (sipas kritereve të përcaktuara në LBGj).

Me qëllim të institucionalizimit të këtij cikli, përfaqësueset politike të grave duhet t'i përdorin këto instrumente juridike që i kanë në dispozicion. Përfaqësimi, pjesëmarrja publike dhe monitorimi i legjislacionit janë mekanizma esenciale që garantojnë zhvillimin e qëndrueshëm të integritit të perspektivës gjinore, si prioritet ndërsektorial për ligjvënien ose zhvillimin e politikave.

# PËRFAQËSIMI I GRAVE: NDIKIMI NË POLITIKËBËRJE DHE NXITJA E SHTRIRJES

## PËRFUNDIMET

Grupi për Ballkan organizoi shtatë konsultime në gjithë Kosovën me gratë anëtare të kuvendeve komunale dhe me gratë anëtare të Kuvendit të Kosovës. Veç kësaj, BPRG-ja ka mbajtur edhe tryeza të rumbullakëta me gra të zgjedhura, me vendimarrës dhe me përfaqësues të mediave, me qëllim që të rris shtrirjen publike të agjendave dhe aktiviteteve të përgjegjshme gjinore.

Aktivitetet kishin për qëllim ndërtimin e raporteve mes përfaqësueseve të grave në nivel lokal dhe qendror me akterët tjerë të rëndësishëm – në veçanti me mediat. Mirëpo, diskutimet i zbuluan mangësitë dhe vështirësitë e shumta me të cilat përballen gratë e zgjedhura. Vështrimet e ndryshme dhe debatet konstruktive gjeneruan përfundime të shumta (të radhitura në vazhdim) që kërkojnë vëmendjen e të gjithë akterëve, institucioneve, politikëbërësve e të gjitha niveleve, mediave dhe donatorëve, me qëllim të përmirësimit të rolit të grave në politikë dhe në vendimarrje dhe të krijimit të një mjedisi më të favorshëm për integrimin e perspektivës gjinore.

## RRJEDHIMISHT, ËSHTË TEJET E RËNDËSISHME TË PRANOJMË SE:

- 1** Partitë politike duhet t'i japin përparësi dhe ta zhvillojnë një përfaqësim më gjithëpërfshirës dhe të barabartë të grave përmes kuotës prej 50 përqind), në pëputhje me Ligjin për Barazi Gjinore. Me qëllim të forcimit të demokracisë së tyre të brendshme, partitë duhet të sigurojnë rolin e gruas brenda strukturave vendimarrëse. Partitë duhet ta shqyrtojnë Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe ta përshtasin atë me Ligjin për Barazi Gjinore.
- 2** Grupi i Grave duhet të ketë një rol më zyrtar në Kuvend, të paktën në aspektin organizativ. Duhet të alokohen mjete financiare për themelimin e një buxheti operacional për Grupin e Grave, t'iu ndahet një zyrë, dhe të rriten kapacitetet e burimeve njerëzore për përkrahjen e aktiviteteve të tyre.
- 3** Anëtarët (meshkuj) e Kuvendit duhet ta mbështesin aktivisht dhe ta miratojnë punën e Grupit të Grave. Mbështetja e politikëbërjes së barabartë gjinore nuk duhet të kuptohet si diçka që i përket vetëm grave.
- 4** Ka nevojë për donator të drejtëpërdrejtë apo/dhe për përkrahje institucionale, me qëllim të rritjes së ndikimit, zgjerimit të fushëveprimit dhe përfshirjes së Grupit të Grave në politikëbërje, në implementimin dhe monitorimin e ligjeve, dhe në avokim e shtrirje në gjithë shtetin.
- 5** Organizatat joqeveritare (OJQ) dhe mediat duhet të fokusohen në trajtimin sa më të afërt të punës së kuvendeve komunale.

- 6** Duhet të themelohet një shoqatë - një forum i zgjedhur në mbarë vendin - e grave deputete dhe anëtareve të kuvendeve komunale, sipas përfaqësimit gjithëpërfshirës gjeografik të gjithë vendit. Kjo shoqatë duhet të përfshihet drejtpërdrejt në promovimin lokal dhe qendror të politikëbërjes së përgjegjshme gjinore, nëpërmes:

Promovimit dhe shtyrjes përpara të pjesëmarrjes së shtuar të grave në konsultimet publike për hartimin e politikave, në përputhje me Rregulloren e Qeverisë për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimeve Publike. Qeveria e Kosovës duhet të kërkojë nga Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQQ) që të zhvillojë një strategji gjithëpërfshirëse qëndrore për pjesëmarrjen e grave në konsultime publike.

Identifikimit të nevojave politike, bazuar në vlerësimet gjinore në nivel lokal dhe qendror.

Formulimit të propozimeve politike, të bazuara në vlerësimet gjinore që dalin nga përfshirja e grave në konsultime publike.

- 7** Ministria e Financave duhet të jetë më këmbëngulëse dhe të luaj një rol më të rëndësishëm në mbikëqyrjen e procesit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në nivel qendror dhe lokal; zyrtarët e saj, dhe personeli i financave/buxhetit nëpër institucione, duhet të aftësohen për buxhetim të përgjegjshëm gjinor.
- 8** Ministria e Financave, në bashkëpunim me Ministrinë e Pushtetit Lokal, duhet të kërkojnë dhe kushtëzojnë miratimin e buxheteve dhe projekteve komunale në rast se konsultimet publike dhe pjesëmarrja e grave në to nuk i plotësojnë kriteret e parapara.
- 9** Anëtarëve të Kuvendit duhet t’iu mundësohen trajnime për buxhetim të përgjegjshëm gjinor, për të rritur kështu kapacitetet e tyre të monitorimit dhe të mbikëqyrjes më efikase të ministrive dhe agjencive qeveritare.
- 10** Komuniteti i donatorëve duhet t’iu mundësojë trajnime për punë grave anëtare të kuvendeve komunale dhe grave deputete.
- 11** Agjencia për Barazi Gjinore, në bashkëpunim me Agjencinë e Statistikave të Kosovës, duhet të realizojnë një monitorim më të rreptë gjatë mbledhjes së të dhënave mbi baza gjinore në komuna dhe institucione qeveritare. Nga drejtoritë komunale duhet kërkuar që mbledhjen e të dhënave mbi baza gjinore ta bëjnë në bashkëpunim me Zyrtarët për Barazi Gjinore (ZBGj). Në qoftë se mbledhja e të dhënave mbi baza gjinore nuk realizohet nga institucionet vendore dhe qendrore, atëherë ky veprim duhet të mbështetet nga mekanizmat e sanksionimit, siç definohet në Ligjin për Barazi Gjinore.

Activity supported by the  
Canada Fund for Local Initiatives  
Activité réalisée avec l'appui du  
Fonds canadien d'initiatives locales

Canada



Norwegian Embassy

Ky publikim është financuar nga Fondi i Inicativave Lokale të Kanadasë (CFLI) – një iniciativë e Qeverisë së Kanadasë. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësia e vetme e Grupit për Ballkan dhe nuk reflekton qëndrimet e donatorëve.



**BPRG** | Balkans Policy  
Research Group

Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan (BPRG) është një organizatë pavarur rajonale, me qendër në Prishtinë, Kosovë. Ne ofrojmë analiza dhe rekomandime të politikave zhvillimore për një sërë çështjesh të ndërlidhura me shtet-ndërtim; konsolidim institucional e demokratik; integrimin e minoriteteve, dhe marrëdhënieve ndërshtetërore; si dhe integrimin Evropian dhe reformave politike. Ne kemi përvijë në hartimin, raportimin dhe zhvillimin e politikave, qasje strategjike dhe avokim me qeverinë, institucione ndërkombëtare dhe organizata joqeveritare.

Në thelbin e punës sonë qëndrojnë raportet tona rigoroze, të detajuar dhe të paanshme, të bazuara gjithmonë në hulumtimet në terren. Ne shkojmë përtej qëndrimeve kryesore dhe kërkojmë të bëjmë ndryshime përmes rekomandimeve për politika të cilat janë krijuese, të realizueshme dhe të matshme, për të ndihmuar në zhvillimin e demokracive të forta dhe shoqërive të bazuara në sundimin e ligjit në Ballkanin Perëndimor.

Ne angazhohemi në avokim të nivelit të lartë, si në rajon ashtu edhe ndërkombëtarisht, duke ndikuar njëkohësisht në diskutime mbi politikën, punët e brendshme dhe politika evropiane për Ballkanin Perëndimor.

Për të arritur këtë, Grupi për Ballkan ka dizajnuar instrumente dhe platforma te reja:

**Dialogu Politik** promovon dialogun e brendshëm të Kosovës, dhe agjendën e krijimit të reformave. Forumi i Politikave (një Forum i Avokimit të Nivelit të Lartë-Mendimtar) u angazhua për të përmirësuar dialogun midis shoqërisë civile dhe institucioneve.

**Grupi për Avokim dhe Politika Kosovë-Serbi (një forum për bashkëpunimin ndërkufitar të shoqërisë civile)** synon të komunikojë, promovojë dhe forcojë dialogun drejt normalizimit të plotë midis Kosovës dhe Serbisë, dhe shoqërive të tyre.

**Gratë në politikë** promovon fuqizimin e grave dhe vajzave; sigurinë dhe gjithë-përfshirjen e tyre; dhe angazhohet të forcoj ndikimin e Grupit të Grave në tërë Kosovën.

**Platforma për Dialogun** promovon procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke informuar publikun më të gjerë dhe duke nxitur debat për marrëveshjet, përfitimet dhe sfidat e Dialogut.

Activity supported by the  
Canada Fund for Local Initiatives  
Activité réalisée avec l'appui du  
Fonds canadien d'initiatives locales

Canada



Norwegian Embassy



WOMEN IN POLITICS & DECISION-MAKING